



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300352/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të burgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Reç, Malësi e Madhe.*

Drejtuar: Z. Admir ABRIJA
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Erion LASKA
Drejtore i IEVP-së Reç, Malësi e Madhe

SHKODËR

I nderuar z. Abrija,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimi që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në IEVP Reç.

Inspektimi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Reç, Malësi e Madhe, u zhvillua nga Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, sipas Planit të Inspektimi, bazuar në nenet 19/1 dhe 30/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe nenin 81 të ligjit 81/2020 "Për trajtimin e të drejtave të dënuarve me burg dhe të paraburgosurve".

Vizita inspektuese u krye në datë 18.04.2023. Në përbërje të grupit të inspektimit ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi, znj.Gloria Çarkaxhiu, znj.Lindita Dedgjoni dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi i vizitës inspektuese në IEVP Reç ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të burgosurve në përputhje me aktet kombëtare dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të të burgosurve; garantimi i sigurisë, shëndetit dhe krijimi i kushteve materiale për jetesë normale dhe aktivitete që ndikojnë në rehabilitimin dhe ri-integrimin e të burgosurve; kontrolli dhe administrimi i dokumentacionit që evidentojnë punën e kryer me të burgosurit sipas sektorëve; si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm¹. Vlen të theksojmë se sipas qëndrimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rekomandimi është pranuar dhe po punohet për zbatimin e tij.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, ka të drejtën e detyrimit ligjor t’ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të adresojë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Bazuar në metodologjinë e inspektimit të MKPT-së në burgje, grupi i inspektimit zhvilloi një takim me drejtorin e institucionit z. Erion Laska dhe shefin e policisë, të cilët u njohën me qëllimin e inspektimit.

Drejtuesit e institucionit informuan në lidhje me respektimin e të drejtave të të burgosurve, kushtet e jetesës, ambientet e përbashkëta dhe aktivitetet që zhvillohen sipas statusit dhe grupmoshave të të burgosurve në institucion, si dhe masat e marra për trajtimin individual psiko-social dhe atë shëndetësor të tyre, nga stafi i institucionit sipas sektorëve përgjegjës.

Referuar Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë "*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*", **IEVP Reç kategorizohet "Burg i sigurisë së zakonshme"**, me një seksion për të dënuarit, një seksion për të paraburgosurit dhe një seksion i kujdesit të veçantë (SKV).

Kapaciteti zyrtar i institucionit **ishte për 781 persona**, bazuar në urdhërin nr.735 prot., datë 04.05.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Në ditën e inspektimit, në IEVP Reç **ishin akomoduar 578 të burgosur**, nga të cilët 375 të dënuar dhe 193 të paraburgosur. Institucioni ka dhe ambiente të tjera për akomodim në sektorin e infermierisë (spitali), SKV-në, si dhe sektorin e observimit e veçimit, në total për 69 persona. Por, këto ambiente janë për qëndrim të përkohshëm të të burgosurve dhe nuk duhet të konsiderohen dhe të llogariten për efekt të kapacitetit zyrtar.

Grupi i inspektimit kërkoi informacion për situatën e popullimit në këtë institucion për periudhën e fundit 6-mujore, e cila rezultoi si më poshtë vijon:

- Muaj Nëntor 2022 597 të burgosur (224 të p/b dhe 373 të dënuar)
- Muaj Dhjetor 2022 582 të burgosur (210 të p/b dhe 372 të dënuar)

¹ Shkresë nr.K4/I59-2 prot., datë 23.11.2022 dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe drejtorit të IEVP Reç.

- Muaj Janar 2023 571 të burgosur (201 të p/b dhe 370 të dënuar)
- Muaj Shkurt 2023 567 të burgosur (204 të p/b dhe 363 të dënuar)
- Muaj Mars 2023 577 të burgosur (205 të p/b dhe 372 të dënuar)

Nisur nga statistikat e raportuara, IEVP Reç rezulton të mos ketë situata mbipopullimi për periudhën e ispektimit. U konstatua se, të paraburgosurit dhe të dënuarit janë të ndarë sipas seksioneve më vehte në 4 (katër) godinat e banimit në regjimin e brendshëm, në përputhje me kategorizimin e institucionit të përcaktuar në urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë.

Struktura organike e IEVP Reç e miratuar me urdher nr.43, datë 25.03.2021 të Kryeministrit të Shqipërisë, ka 384 punonjës, nga të cilët 58 punonjës civil dhe 326 staf i policisë të institucionit. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, kishte mungesa në stafin civil 1 mjek psikiatër dhe 2 punonjës të sektorit të çështjeve shoqërore, ndërsa në stafin e policisë kishte 100 vende vakante për punonjës policie.

Mungesat në organikë, përbëjnë problem shqetësues për garantimin e sigurisë, jetës dhe shëndetit të të burgosurve, ndaj është e domosdoshme të përshpejtohen procedurat për rekrutimin sa më parë të punonjësve civil dhe atij policor, pasi IEVP Reç është një burg me infrastrukturë dhe kapacitet të madh, ndaj për menaxhimin e tij kërkohet që organika të jetë e plotësuar në përputhje me strukturën organike të miratuar.

Nga verifikimi i rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, rezultoi se ishin zbatuar disa nga masat si më poshtë vijon:

- ✓ Në sektorin e shëndetësisë ishte punësuar dhe 1(një) mjek i përgjithshëm me kontratë me kohë të pjesëshme, por ende është vakant pozicioni i mjekut psikiatër.
- ✓ Ishte vënë në funksionim sistemi qendror me “chiller” që shërben për ngrohje/ftohjen e ambienteve në regjimin e brendshëm të institucionit.
- ✓ Institucioni kishte furnizim ujë të rrjedhshëm dhe ujë të ngrohtë, me qëllim mbajtjen e higjienës personale të të burgosurve, larjen e trupit dhe pastërtinë e ambienteve të përbashkëta.
- ✓ Numrat e kontaktit të Avokatin e Popullit, ishin të afishuar në vende të aksesueshme dhe të burgosurit komunikonin rregullisht nëpërmjet telefonave të vendosur në çdo sektor, me qëllim adresimin e ankesave të tyre.
- ✓ Pagesa për të punësuarit, kryhej rregullisht çdo muaj në zbatim të VKM-së nr.602, datë 13.10.2021.
- ✓ Të burgosurve ju jepej mundësia të konvertonin, me miratim të drejtorit të institucionit, takimin fizik me takim me “skype” me familjarët e tyre, sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithëshme të Burgjeve miratuar me VKM nr.209, dt.06.04.2022.

- ✓ IEVP Reç në bashkëpunim me Spitalin Rajonal Shkodër dhe Qendrën Shëndetësore Koplík, kishin marrë masa për kryerjen e analizave mjekësore të të burgosurve, sipas rekomandimit të mjekut të institucionit dhe mjekut specialist.

Gjithashtu, u evidentua se disa nga rekomandimet nuk ishin plotësuar, si më poshtë vijon:

- ✓ Nuk ishte plotësuar organika e sektorit të çështjeve shoqërore me 2 punonjës psikolog/punë sociale.
- ✓ Nuk ishin plotësuar vendet vakante në stafin e punonjësve të policisë, sipas funksioneve në strukturën organike (vitin e kaluar mungonin 94 punonjës policie).
- ✓ Nuk ishin vënë në funksion, ambientet e palestrës që ndodhet në regjimin e brendshëm të institucionit.

Vizita inspektuese u krye pa paralajmërim dhe pa mbikqyrjen e stafit të institucionit gjatë inspektimit në ambientet e brendshme, si dhe zhvillimit të intervistave konfidenciale me të burgosurit, në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Trajtimi i të burgosurve

Grupi i inspektimit zhvilloi intervista konfidenciale me të burgosurit, me qëllim identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të lejuar apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie. Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarit dhe të paraburgosurit, nuk u evidentuan raste apo pretendime nga të burgosurit për keqtrajtime dhe tejkallim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni.

Gjatë vizitës inspektuese, vëmendje e veçantë ju kushtua edhe verifikimit të procedurave që ndiqen nga stafi i institucionit:

- ❖ për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të të burgosurve nga administrata e institucionit;
- ❖ funksionimi i komisionit të pritjes në lidhje me trajtimin e të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion;
- ❖ funksionimi i komisionit për dhënien e masës disiplinore dhe trajtimi i të burgosurve me masë disiplinore;
- ❖ aktivitetet kulturore, edukative dhe sportive që zhvillohen me të burgosurit;
- ❖ ofrimi i shërbimeve bazike dhe trajtimi shëndetësor për të burgosurit;
- ❖ cilësia e gatimit të ushqimit dhe larmishmërinë e ushqimit;
- ❖ furnizimit të të burgosurve sipas normativave mujore me detergjente dhe mjete të higjenës personale, etj.

Në këtë kuadër, infrastruktura në regjimin e brendshëm të institucionit, për mbarëvajtjen e punës të stafit dhe aktivitetit të të burgosurve, ishte e plotë dhe funksionale. Ambientet e banimit dhe ato ndihmëse, mundësojnë jetesë normale dhe veprimtarinë e të burgosurve, sipas kategorieve dhe grupmoshave.

Godinat e banimit dhe ambientet e përbashkëta në regjimin e brendshëm janë në gjendje të mirë teknike. Nga inspektimi, u evidentua se të paraburgosurit ishin të vendosur në një godinë banimi, ndërsa të dënuarit ishin vendosur në tre godina banimi. Ambientet ndihmëse, në shërbim të aktivitetit që kryhet me të burgosurit, janë të organizuara në një godinë më vehte.

Pavarësisht infrastrukturës dhe ambienteve në regjimin e brendshëm, që janë për tu vlerësuar pozitivisht, të burgosurit i paraqitën ankesa grupit të inspektimit për vonësa në kryerjen e vizitave mjeksore apo për zvarritje të ekzekutimit të rekomandimeve të mjekut të institucionit, për kryerjen e vizitave mjeksore pranë mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Shkodër. Këto janë ankesa të përsëritura edhe më parë nga të burgosurit. Lidhur me këtë shqetësim, grupi i inspektimit kërkoi informacion nga drejtori dhe mjeku i institucionit. Sipas informacionit, koha në dispozicion për kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku, në varësi të kërkesave dhe diagnozës që paraqisnin të burgosurit, varioonte brënda ditës ose maksimumi brënda 2 ditëve. Ndërsa, për vizitat mjeksore pranë mjekëve specialistë në Spitalin Rajonal të Shkodrës, kryheshin në varësi të masave të sigurisë për lëvizjen e të sëmurëve nga IEVP për në spital, mundësisht menjëherë për rastet urgjente, ndërsa për të sëmurët kronikë koha e pritjes shkonte deri në 10 ditë. Aktualisht, institucioni kishte punësuar edhe një mjek me kohë të pjesëshme, brenda strukturës organike, që shkurronte kohën e vizitave mjeksore të pacientëve me probleme shëndetësore.

Në vlerësimin e MKPT-së, pavarësisht masave për përmirësimin e shërbimit shëndetësor në këtë institucion, çdo vonesë sado e justifikuar, përbën kufizim të së drejtës themelore të të burgosurve për të marrë shërbim shëndetësor në kohë sa më të shpejtë dhe cilësor, pranë spitaleve publike apo klinikave mjeksore që ndodhen në qytetin e Shkodrës.

Të burgosurit ngritën si shqetësim mungesën e aktiviteteve kulturore dhe sportive me pjesëmarrjen e gjerë të të burgosurve, ankesë e përsëritur vit pas viti në këtë institucion, të cilat vazhdojnë të mungojnë ende. Aktivitetet e vetme që zhvilloheshin me të burgosurit ishte orari i ajrimit dhe lojrat e tavolinës në hollin e çdo sektori, të cilat janë të pamjaftueshme në qëllimin që kanë, për ruajtjen e shëndetit fizik e mendor, si dhe për rehabilitimin e kësaj kategorie. Në këtë kuadër, autoritetet e institucionit kanë detyrimin që të organizojnë aktivitete të veçanta me të burgosurit, sipas nevojave që ata kanë. Rregullorja Europiane e Burgjeve parashikon që të burgosurve t'u organizohen veprimtari për kalimin e kohës së lirë, ku të përfshihen sportet, lojrat, aktivitetet kulturore, hobet dhe aktivitete të tjera. Gjatë veprimtarive të burgosurit duhet të lejohen të shoqërohen me njëritjetrin dhe bashkarisht të organizojnë kohën e lirë².

Nga periudha e pandemisë Covid-19, një nga masat kufizuese ende e pashfuqizuar është ajo e lejeve shpërblyese për të dënuarit që plotësojnë kushtet ligjore të përfitimit të kësaj

² Pika 27.6 dhe 27.7 e Rregullores Europiane të Burgjeve. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

të drejte³. Të dënuarit ngritën me shqetësim shumë ankesa, se në mënyrë të paarsyeshme ata janë ende të privuar nga kjo e drejtë. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, ende nuk ka dalë udhëzimi i Ministrisë të Drejtësisë⁴, që i hap rrugë procedurave për marrjen e kërkesave për leje shpërblyese dhe miratimin e tyre nga organi i parashikuar në ligj, sipas kategorizimit të të dënuarve.

Avokati i Popullit në mënyrë periodike, nga viti 2022 kur u hoqën plotësisht masat kufizuese⁵, ka rekomanduar nxjerrjen e udhëzimit të Ministrisë të Drejtësisë të lartëpërmendur dhe fillimin e procedurave për dhënien e lejeve shpërblyese për të dënuarit, por pavarësisht se ka kaluar një vit, konstatohet se ky rekomandim ende nuk është zbatuar. Kjo situatë, krahas mohimit të kësaj të drejte të ligjshme të të dënuarve, është edhe mungesë bashkëpunimi i këtij organi të lartë të administratës publike me Avokatin e Popullit për zbatimin e rekomandimeve të tij, që janë në të njëjtën kohë edhe detyrim ligjor.

Një problematikë tjetër që u evidentua nga intervistat me të paraburgosurit, kishte të bënte me zvarritjet e pajustificuara në zbardhjen e vendimeve nga ish-Gjykata e Apelit Shkodër dhe ekzekutimi në kohë i tyre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ata pretendonin se, me ndryshimin e hartës gjyqësore dhe krijimin vetëm të një Gjykate Apeli, kjo situatë do rëndohet më shumë. Nga verifikimi i dokumentacionit të të burgosurve që ngritën këto ankesa, rezultoi se zvarritja e zbardhjes së vendimeve shkonte nga 6 muaj deri në 1.5 vjet.

Sigurisht kjo është një situatë e pajustificueshme dhe në shkelje të dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale⁶. Pavarësisht se situata ka të bëjë me procedurat e organeve gjyqësore dhe të prokurorisë, në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, administrata e IEVP-së duhet të bashkëpunojë më shumë dhe të jetë proaktive me administratat e organeve respektive, pasi është e pajustificuar një zvarritje kaq e gjatë e zbardhjes së vendimeve gjyqësore.

Që në krijimin e këtij institucioni, grupet e monitorimit të MKPT-së, kanë evidentuar një problematikë që ka të bëjë me ambientet në IEVP Reç (kryesisht te godina e shërbimeve ndihmëse) të cilat janë të mbyllura dhe të pashfrytëzuara, ndaj është rekomanduar që ato mund dhe duhet të kthehen në funksion të aktiviteteve për të burgosurit. Ndërtimi i godinave dhe ambienteve në regjimin e brendshëm janë të projektuara dhe të konceptuara

³ Neni 72 i ligjit 81/2020 ku thuhet se: “Leja shpërblyese i jepet në rastin e përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

- a) të dënuarit deri në 3 vjet burgim, pasi të ketë kryer jo më pak se 1/4 e dënimit;
- b) të dënuarit nga 3 deri në 10 vjet burgim, pasi të ketë kryer jo më pak se 1/2 e dënimit;
- c) të dënuarit mbi 10 vjet burgim, pasi t’i ketë mbetur për të kryer më pak se 5 vjet heqje lirie”.

⁴ Neni 72/7 i ligjit 81/2020: “Procedurat e dhënies së lejeve shpërblyese përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Drejtësisë”.

⁵ Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 133, datë 7.4.2022 Për shfuqizimin e urdhrit nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar

⁶ Neni 430/1 pika 4 e K.Pr.Penale thueht shprehimisht se: “Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”.

si një ansambël i tërë, që u jep mundësinë të burgosurve si për jetesë normale ashtu dhe për organizimin e aktiviteteve të larmishme me grupe sipas interesave që kanë të burgosurit dhe me pjesmarrje të gjerë të tyre. Edhe ato ambiente të parashikuara për palestëra në këtë institucion janë ende bosh dhe të pa plotësuara me pajisje dhe vegla të forcës, ku të burgosurit të mund ta përdorin ato, për ushtrime fizike dhe për kalimin e kohës së lirë. Nevojat për aktivitete alternuese janë të mëdha dhe duhet të jenë në vëmendjen e Dr.P.B edhe për shkak të situatës së kaluar nga pandemia dhe mungesës shumë të gjatë të përfitimit të lejes shpërblyese.

Masat mbrojtëse

Grupi i inspektimit, verifikoi funksionimin e sistemit të kërkesë/ankesave të të burgosurve dhe zgjidhjen e tyre, si dhe trajtimi i korrespondencave në rastin kur të burgosurit i drejtohen me kërkesë institucioneve të tjera jashtë sistemit të burgjeve.

Nga intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe kontrolli i regjistrit ku evidentohet ecuria e kërkesë/ankesave të të burgosurve që nga plotësimi i formularit deri te zgjidhja e tyre, rezultoi se, sistemi i kërkesë/ankesave funksiononte sipas kërkesave të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve⁷.

Sipas praktikës të konsoliduar në këtë institucion, specialistët e sektorit të çështjeve shoqërore ishin personat përgjegjës të autorizuar të cilët në mënyrë periodike merrnin kërkesë/ankesat e të dënuarve/paraburgosurve. Në vijim, ata kryenin regjistrimin e tyre në regjistrin përkatës që mbahej në sektorin e protokoll-arshivës së institucionit dhe më tej i dërgonin ato te drejtori i institucionit. Specialistët sipas sektorëve, në varësi të shënimeve të drejtuesit të institucionit, kryenin trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e institucionit⁸.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, për periudhën janar- prill 2023 ishin regjistruar 374 kërkesa nga të burgosurit, me objekt blerje TV, biseda në “skype” me familjen, aplikim për hapje llogarie në bankë, kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku, vizitë te mjekët specialist në Spitalin Rajonal Shkodër, mungesë të medikamenteve mjeksore, pajisjen me kopje të vendimit të gjykatave, konsulenca juridike, etj.

Grupi i inspektimit nuk mori ankesa në lidhje me procedurat që ndiqen nga stafi i institucionit në lidhje me trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të tyre nga drejtuesit e institucionit. Por ata ngrinin si ankesë, mungesën e kontaktit me juristin dhe punonjësit e edukimit të institucionit, në lidhje me dhënien e asistencës ligjore për çështje që shqetësojnë të burgosurit, si dhe për ti informuar në kohë me ecurinë e zgjidhjes së kërkesës së tyre. Gjithashtu, ata ngrinin problemin e vonësive të përgjigjeve edhe nga

⁷ Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020: “Personeli i autorizuar **organizon takime periodike me të burgosurit, me qëllim krijimin e mundësive të paraqitjes së kërkesave ose ankesave. Rregullat dhe procedurat për shpeshhtësinë, kohën e takimeve dhe mënyrën e zhvillimit të tyre përcaktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**”.

⁸Neni 58 i ligjit Nr.81/2020: “Çdo institucion **mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose të ankesave të të burgosurve në formë shkresore dhe elektronike**”.

DPB-ja, kryesisht të kërkesave që kishin të bënin me transferimin e tyre për në I EVP-të e tjera.

Gjatë inspektimit u verifikuan gjithashtu procedurat e ndjekura për hyrjet e reja të të burgosurve në institucion, ngritja dhe funksionimi i komisionit të pritjes, intervistimi i të burgosurve, evidentimi i gjendjes shëndetësore dhe psiko-sociale të tyre, si dhe mënyrën e plotësimit të regjistrit dhe dosjeve personale të të burgosurve. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni u konstatua se, procedura e pranimit të të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion zbatohet në mënyrë korrekte nga komisioni i pritjes, praktikë kjo e cila ishte e evidentuar në libër dhe në regjistrin përkatës. Më tej, dokumentacioni protokollohej në sekretarinë e institucionit.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Mbulimi me kamera në I EVP Reç, kryhej nga 468 kamera të cilat monitoronin ambientet në regjimin e brendshëm, si dhe mjediset e jashtme të institucionit përgjatë 24 orëve. Të dhënat nga regjistrimet e kamerave ruhen në server për një periudhë 30 ditore. Mbikqyrja me kamera e ambienteve në regjimin e brendshëm të I EVP-ve, përveç mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, si një masë mbrojtëse ndaj personave të privuar nga liria, për arsye se, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve. Mbikqyrja me kamera, dokumenton gjithashtu shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgjeve dhe paraburgime, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës. Dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Komunikimi me telefon i të burgosurve me familjet e tyre, kryhej 2 herë në javë, sikurse është e përcaktuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, nëpërmjet telefonave me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve dhe në ambientet e ajrimit në regjimin e brendshëm. Të burgosurit nuk paraqitën ankesa për bisedat telefonike me familjarët e tyre, por paraqitën kërkesa për shtimin e operatorëve të tjerë telefonik, pasi monopoli i këtij shërbimi në sistemin e burgjeve, ka sjellë për pasojë rritjen e çmimit të kartave telefonike dhe uljen e minuatave të bisedave telefonike. Ky shqetësim është ngritur nga të burgosurit edhe në I EVP-të e tjera.

Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët, kishte 27 poste për takime fizike me familjarët, 7 poste për takime online, 2 dhoma prindërimi për të burgosurit familjarë, 8 dhoma për takime speciale për të dënuarit familjarë, si dhe 2 dhoma për takimin e të burgosurve me avokatët mbrojtës dhe prokurorët e çështjes. Në intervistat me të burgosurit, ata zhvillonin 3 takime fizike dhe 1 takim online me familjarët e tyre ose dhe

konvertimin e takimit fizik me takim online, sipas kërkesës të të burgosurve⁹. Grupi i inspektimit nuk mori ankesa për takimet me familjarët, por ata propozonin që me kërkesë të arsyetuar nga të burgosurit, takimi fizik të zëvendësohej me takime online me familjarët, brenda numrit të përgjithshëm të takimeve mujore, duke mos i kufizuar vetëm me një takim online. Takimet me familjarët janë të rregulluara sipas Rregullores së Përgjithëshme të Burgjeve miratuar me VKM nr.209, datë 06.04.2022.¹⁰

Dhomat e prindërimit të takimeve të të burgosurve familjarë me familjet e tyre, janë të pajisur me orenditë e nevojshme si tavolinë dhe karrige. Në këto dhoma, aktualisht zhvillonin takime të burgosurit me fëmijët e tyre, por edhe me familjarët. Gjatë takimeve të të burgosurve me fëmijët dhe familjarët e tyre, në këto ambiente respektohen masat e sigurisë, si dhe privacia e takimit.

Kushtet materiale

IEVP Reç është një institucion i ri, që ka filluar aktivitetin në vitin 2018. Ky institucion, plotëson të gjitha kushtet dhe standardet e trajtimit të personave të paraburgosur dhe të dënuar. Ato i përafrohen standardeve të Bashkimit Evropian, në lidhje me akomodimin, sistemet e ngrohjes, regjimin e aktiviteteve ditore, aktiviteteve sociale, kulturore, edukimit, si dhe atyre sportive etj.

Infrastruktura e godinave, ambientet e dhomave të banimit, mjediset e ajrimit dhe ambientet e përbashkëta, janë në gjendje të mirë teknike dhe plotësojnë kërkesat jetësore të të burgosurve. Në regjimin e brendshëm ndodhen 5 godina me tre kate, 1 (një) godinë për të paraburgosurit, 3 (tre) godina për të dënuarit dhe 1 (një) godinë për shërbimet ndihmëse. Çdo godinë banimi ka më vehte ambiente të përbashkëta për aktivitete dhe mjedise ajrimi.

Ky lloj organizimi është edhe për secilin sektorë që ndodhet në katin e secilës godinë banimi. Çdo sektor ka dhoma banimi, klasë edukimi dhe për këshillime individuale, dushe dhe dhomë për lavanderinë. Ndërsa klasat ku zhvillohej mësimi 9-vjeçar, kurset profesionale, biblioteka dhe ambientet e kultit, janë të përbashkëta të ndara më vehte sipas interesave dhe besimeve fetare të të burgosurve. Por, sikurse e theksuam edhe më lartë, në godina ka shumë ambiente (dhoma) që janë të boshatisura dhe pa funksione. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, ato ambiente janë të ndërtuara që në zbatimin e projektit, por nuk përdoren pasi për të venë ato në funksion, kërkohen stafe mbështetëse dhe staf sigurie shtesë mbi strukturën organike të miratuar.

Dhomat e banimit në çdo sektor janë të organizuara në dhoma teke dhe dhoma për dy persona, me parametra të tillë që mundësojnë akomodimin e të burgosurve për jetesë normale. Hapsira dhe sipërfaqja e dhomave ishte sipas normave të lejueshme (kubatura jo

⁹ Takimet me familjarët në të gjitha burgjet e vendit zhvillohen 4 herë në muaj nga këto 3 takime fizike dhe 1 takim online, në bazë të Rregullores së Përgjithëshme të Burgjeve miratuar me VKM nr.209, dt.06.04.2022.

më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur)¹¹, ndërkohë që dritaret lejonin ajrim dhe dritë të plotë natyrale. Ato ishin të pajisura me tavolina, karrige, sirtarë plastikë, televizor, frigorifer, ventilatorë personale (ngrohje/ftohje), etj. Krevatet nëpër qelitë ishin prej hekuri dhe të kompletuara me dyshekë sfungjeri, çarçafë, batanije. Tualetet ishin brenda qelive të pajisura me lavamane dhe WC të rregullta, ndërsa për larjen e trupit çdo sektor, ka ambiente dushi të përbashkëta.

Duset kolektive ishin të pajisura me bolierë normal për ngrohjen e ujit. Ambientet e banjave dhe të dusheve kolektive ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por kishin lagështirë për shkak të mungesës të ajrimit.

Në hollin e korridoreve të sektorëve ka ambiente të përbashkëta me tavolina dhe karrige ku zhvillohen lojëra tavoline si shah, domino dhe lojëra me letra. Çdo sektor ka të instaluar telefona me kartë që të burgosurit mund të komunikojnë me familjet e tyre, si dhe kuti postare për hedhjen e kërkesë/ ankesave, të cilat hapen nga punonjësit e autorizuar nga drejtori i institucionit.

Ambientet në regjimin e brendshëm kanë energji elektrike 24 orë që furnizohet nga rrjeti elektrik, si për ndriçim dhe për plotësimin e nevojave të higjienës personale. Ndërkohë, institucioni ka dhe burim energjie rezervë me gjeneratorë, për furnizimin me energji elektrike në rast ndërprerje.

Furnizimi me ujë kryhej nga rrjeti i ujësjellësit të Malësisë së Madhe, nëpërmjet një linje të dedikuar për këtë institucion. Ambientet në regjimin e brendshëm furnizohen me ujë, sipas grafikut të afishuar dhe të miratuar nga titullari i institucionit, katër herë në ditë me nga dy orë. Të burgosurit, nuk kishin ankesa për furnizimin me ujë, por kishin kërkesa që furnizimi me ujë të ishte i pandërprerë, me qëllim që ti përgjigjet nevojave të të burgosurve për mbajtjen e higjienës personale, si dhe pastërtinë e ambienteve të banimit dhe atyre të përbashkëta.

Ushqimi gatuhej rregullisht çdo ditë dhe shërbehej në 3 vakte, i ndarë më vehte për të burgosurit dhe për të sëmurët me diabet. Kuzhina e institucionit, është me hapësirë e sipërfaqe të madhe dhe ambiente më vehte për gatimin e ushqimit dhe për ruajtjen e produkteve të ushqimit. Ajo ishte e kompletuar me pajisje frigoriferike (3 ftohës dhe 1 frigorifer), me pajisje gatimi kuzhine alternative (elektrike dhe gaz) për gatimin e vakteve ushqimore, si dhe karroca dhe vaska nikelato për shpërndarjen e ushqimit, të cilat janë të reja dhe me një cilësi shumë të mirë.

Në ambientin e kuzhinës ndodhej e afishuar kuota ditore, menyja, si dhe librezat shëndetësore të personelit guzhiner dhe ndihmës guzhiner. Nga verifikimi i tyre, menuja e ushqimit nuk ishte e përditësuar për çdo javë dhe e miratuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim nga drejtori i institucionit. Kampionët e ushqimit ruhen sipas vakteve në kushte frigoriferike, në një kuti të mbyllur me çelës dhe të vulosur nga punonjësi i policisë të informacionit.

¹¹ Neni 33/4 i ligjit 81/2020 "Për trajtimin e të drejtave të dënuarve me burg dhe të paraburgosurve".

Personeli i kuzhinës përbëhej nga 5 kuzhiner dhe 11 ndihmëskuzhiner të punësuar nga të dënuarit/paraburgosurit, sipas strukturës organike. Në intervistat me të dënuarit dhe të paraburgosurit, nuk u paraqitën ankesa lidhur me cilësinë e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit, por ata kishin pretendime për mungesën e larmishmërisë së vakteve ushqimore. Kjo kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të stafit të logjistikës, sektorit shëndetësor dhe të burgosurve të institucionit, në përgatitjen e një menuje javore që ti përgjigjet shijeve, gjendjes shëndetësore dhe besimive fetare të të burgosurve¹², sikurse përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

Regjimi dhe aktivitetet

Rregullorja e përgjithshme e burgjeve përcakton rregulla për trajtimin, regjimin dhe sjelljen e të burgosurve në institucion, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.81/2020, me synim rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve.

Aktiviteti i të burgosurve ishte i parashikuar në orarin e veprimeve ditore të miratuar nga drejtori i institucionit. Orari ditor ishte i unifikuar për të gjithë sektorët, pavarësisht sigurisë të të burgosurve, ndërsa programi i aktiviteteve që zhvilloheshin me të burgosurit ishin të ndara sipas grup moshave dhe kategorizimit të të burgosurve, më vehte për të dënuarit dhe më vehte për të paraburgosurit.

Spektori për çështjet shoqërore në bashkëpunim me punonjësit e sektorit të sigurisë, ishin përgjegjës për organizimin dhe mbarëvajtjen e mbarëvajtjen e aktiviteteve. Oraganika e këtij sektori përbëhet nga shefi i sektorit dhe 6 punonjës, me profesion psikolog dhe punonjës social. Në stafin e këtij sektori kishte mungesa në organikë, 2 punonjës social dhe 1 specialist psikolog.

Grupi i inspektimit verifikoi dokumentacionin që administrohej nga sektori i çështjeve shoqërore. U evidentua se, sektori ka programe mujore për aktivitetet, programe për trajtimet individuale psiko-sociale, si dhe plane të aktiviteteve për festat kombëtare dhe festat fetare. Për çdo të dënuar dhe të paraburgosur ishin hapur dosjet psiko-sociale, të cilat ishin të plotësuar sipas rubrikave.

Në intervista me të burgosurit, u paraqitën ankesa në lidhje me llojshmërinë e aktiviteteve. Ata deklarorin se të vetmet aktivitete që organizoheshin në institucion ishin lojrat e tavolinës, kalçeto dhe aktivitetet fetare, por mungonin aktivitetet masive me karakter kulturor, sportiv dhe edukativ që paraqisnin interes për të burgosurit. Ankesa u paraqitën gjithashtu dhe për mungesën e kontakteve të përditshme të stafit psiko-social me të burgosurit, me qëllim dhënien e asistencës për problematikat që ata i shqetësonin.

¹² Neni 36 i ligjit 81/2020: “Të burgosurit i sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, natyrën e punës, kushtet klimaterike, besimin fetar dhe nevojat e veçanta të tij”.

Në këtë kuadër, aktet ligjore dhe standardet ndërkombëtare parashikojnë detyrimin që institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, duhet të planifikojnë dhe organizojnë aktivitete, të cilat të jenë të alternuara, të shumëllojshme dhe që të ngjallin interes për të burgosurit. Në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, thuhet shprehimisht se: *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹³.

Institucioni i Avokatit të Popullit, sugjeron nevojën e menjëhershme të ndërthurjes së aktiviteteve kulturore-sportive dhe edukative me të burgosurit sipas grup moshave dhe kategorive, si dhe hartimin e programeve për këshillimin dhe trajtimin individual të këtyre personave, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet te këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive me botën jashtë, gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit.

Një eksperiencë pozitive, ishte zbatimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet DPB-së dhe Shoqatës “Pro-Eksport Albania” lidhur në 25 Janar 2021, për krijimin e mundësive për punësimin e personave të burgosur. Grupi i inspektimit verifikoi ambientet dhe kushtet e punës, kryesisht në punimet e drurit dhe të kashtës, ku u gjetën 2 grupe me 20 persona të punësuar në këtë sektor. Këto punime tregtoheshin, duke siguruar të ardhura financiare për të burgosurit e vetëpunësuar.

Organika e të burgosurve të punësuar, kishte të miratuar 48 persona, por në listëpagesën e muajit të fundit ishin punësuar 44 të burgosur në pozicione pune si nd/kuzhiner, sanitar, lulishtar, lavanderi, bibliotek etj. Institucioni kishte lidhur kontratat e punës me të punësuarit dhe pagesat kryheshin çdo muaj, duke i derdhur në numrat e llogarive të të punësuarve në bankat e nivelit të dytë. Disa të punësuar, kishin pretendime se nuk ishin kryer pagesat mujore, por nga informacioni i drejtuesve të institucionit, kjo situatë ishte krijuar për shkak të mungesës të kartave të identitetit dhe pamundësisë për hapur numrat e llogarisë. Institucioni u kishte krijuar mundësinë të punësuarve që ju kishte përfunduar afati i skadencës të kartave të identitetit, të aplikojnë për karta të reja në bashkëpunim me ish-kompaninë “ALEAT” dhe komisariatit e policisë Malësia e Madhe. Ndërsa të punësuarit që kanë deklaruar humbjen e kartës së identitetit, procedura vështirësohet pasi i burgosuri paraprakisht duhet të bëjë denoncimin pranë komisariatit të policisë sipas vendbanimit të tij. Për sa më sipër, duhet të garantohet zgjidhja e këtij problem me natyrë burokratike.

Në çdo rast, IEVP Reç garanton se fondi i pagave për 48 të punësuarit e miratuar nga DPB-ja është në buxhetin e institucionit, por do të bëhet efektiv pasi të hapen numrat e llogarisë në bankë nga çdo i punësuar.

¹³Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDS/ETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>.

Shërbimi Shëndetësor

Në kohën e inspektimit në I EVP Reç, gjendja shëndetësore e të burgosurve paraqitej si më poshtë vijon:

- ❖ të sëmurë kronikë 62 persona;
- ❖ të sëmurë me probleme kardiologjike 23 persona;
- ❖ të sëmurë me probleme të shëndetit mendor 17 persona;
- ❖ të sëmurë me probleme stomatologjike 12 persona;
- ❖ persona që trajtohen me metadon 6 persona, etj.

Spektori shëndetësor, kishte në organikë 16 punonjës, nga të cilët 3 mjekë (2 mjek të përgjithshëm dhe 1 mjek psikiatër), 1 mjek stomatolog, 1 farmacist dhe 11 infermier. Aktualisht institucioni ka të punësuar 2 mjekë të përgjithshëm me kohë të pjesshme, ndërkohë që mungon një mjek me specialitet psikiatër. Bazuar në kushtet e kontratës së punës, mjekët kryenin vizita mjekësore sipas orareve 4(katër) orë çdo ditë, duke i alternuar oraret me qëllim që njëri prej tyre të ishte prezent në institucion, ndërsa për rastet urgjente mjekët paraqiten menjëherë në institucion. Pjesa tjetër e stafit shëndetësor, ishte e plotësuar me mjek dhe infermier sipas organikës dhe ishin të punësuar me kohë të plotë.

Pavarësisht situatës pozitive, në intervistat e zhvilluara me të dënuarit dhe të paraburgosurit, disa prej tyre paraqitën ankesa për vonesa në kryerjen e vizitave mjekësore nga mjekët e institucionit, si dhe për vizitë nga mjekët specialist pranë Spitalit Rajonal Shkodër. U verifikua regjistri i vizitave mjekësore të të burgosurve, ku rezultoi se për periudhën e muajit prill 2023, stafi i mjekëve të institucionit kishte kryer 35 vizita mjekësore, ndërsa për konsulta të mjekët specialist jashtë sistemit të burgjeve ishin kryer gjithashtu 35 vizita mjekësore. Trajtimi mjekësor i pacientëve, kryhej në bazë të protokolleve shëndetësore me rekomandim të mjekëve të institucionit dhe mjekëve specialistë në vizitat mjekësore të kryera pranë Spitalit Rajonal Shkodër ose QSUT-së në Tiranë.

I EVP Reç ka dy ambiente për dhënien e shërbimit shëndetësor, ambienti i spitalit dhe ambienti i seksionit të kujdesit të veçantë (SKV). Në dhomat e spitalit shtrohen kryesisht pacinetë për raste të urgjencave dhe të sëmurët kronikë, ndërsa në seksionin e kujdesit të vecantë (SKV) trajtohen të sëmurë me probleme të shëndetit mendor. Në rastet e urgjencave dhe shoqërimin e pacientëve për në spitalin rajonal në Shkodër, institucioni ka në dispozicion edhe një mjet ambulancë, e cila është e re dhe në gjendje pune.

Spitali ka 9 dhoma me kapacitet për 9 persona. Në kohën e inspektimit ndodheshin të shtruar 9 (nëntë) pacientë të sëmurë kronikë, me rekomandim të mjekut të institucionit. Në mjedisin e spitalit ndodhej **dhoma e mjekut** e kompletuar me të gjitha orënditë dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe rafti për mbajtjen e kartelave shëndetësore për secilin të burgosur; **dhoma e stomatologut** e pajisur me kabientin e ri për kryerjen e vizitave dhe mbushjen e dhëmbëve; **dhoma e farmacistit** ku mbahehin ilaçet dhe regjistri për hyrjet dhe shpërndarjen e medikamenteve sipas rekomandimit të

mjekut të institucionit; **dhoma e terapisë (infirmierëve)**, si dhe **ambientet e përbashkëta** si tualete dhe dushe për larjen e trupit të pacientëve.

Ambienti i dentistit ishte i rregullt dhe i pajisur me poltronë të posaçëm, tavolinë, karrike, raft dhe kutinë e ndihmës së shpejtë të pajisur me ilaçet e nevojshme. Farmacia ishte e mirëmbajtur dhe plotësuar me rafte kur ruheshin ilaçet, si dhe me frigorifer të posaçëm për ilaçet që kërkonin ruajtjen në temperatura të ulëta.

SKV ka 18 dhoma dhe në momentin e inspektimit ndodheshin të shtruar 15 pacientë që trajtoheshin me probleme të shëndetit mendor. SKV kishte edhe ambiente të përbashkëta për ajrim, tualete dhe dushe për larjen e trupit. Në SKV ndodhej i shtruar dhe 1 i burgosur me aftësi të kufizuara (me karrocë), i cili paraqiti një ankesë për mungesën e kujdestarit, pasi çdo shërbim e kryente me ndihmën e punonjëve të policisë që kryenin shërbim në këtë sektorë.

Skema e rimbursimit të ilaçeve, funksionon në bazë të kontratës të lidhur mes FDSKSH-së, depos farmaceutike dhe institucionit, referuar historikut të sëmundjeve kronike për të dënuarit dhe të paraburgosurit. Furnizimi me ilaçe i institucionit, kryhej gjithashtu në mënyrë periodike nga sektori i shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe për nevoja urgjente, përmes blerjeve të drejtëpërdrejtë nga fondet e akorduara në buxhetin e institucionit. Riqarkullimi i ilaçeve kryhej sipas procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe nuk kishte ndodhur që ilaçet të skadonin dhe të groposeshin.

Të gjithë të paraburgosurit pavarësisht nëse janë apo jo të sëmurë, ishin të pajisur me kartela mjekësore. Të gjitha këto dokumentoheshin në regjistra të veçantë dhe në kartelat mjekësore ku përveç të tjerash përshkruheshin në to të gjithë veprimet me të sëmurët si p.sh vizitat, diagnozat, medikamentet, injeksionet, ekzaminimet e bëra, konsultimet dhe rekomandimet e bëra nga specialistët e ndryshëm të poliklinikave dhe të spitaleve, etj. I gjithë ky dokumentacion dhe material statistikor ruhet në dosjet përkatëse dhe në rafte të posaçme.

Përveç regjistrit të vizitave mjekësore, në dhomën e mjekut ndodhej edhe regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës fizike dhe formatet e kontrollit mjekësor sipas Protokollit të Stambollit¹⁴, të cilat ishin të sekretuara, të plotësuar sipas rubrikave dhe mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës.

Ndërsa në dhomën e infirmierisë, ndodhej regjistri i informacionit 24 orësh që mbahej nga personeli i infirmierëve, si dhe regjistri për shpërndarjen e medikamenteve të sëmurëve të burgosur në bazë të rekomandimit të mjekut, të cilat ishin të sekretuar.

Avokati i Popullit, vlerëson kushtet infrastrukturore të krijuara në këtë institucion për dhënien e shërbimit shëndetësor të burgosurve, por thekson se, mungesa e shërbimit

¹⁴ <https://www.ohchr.org/EN/pages/home.aspx>
<http://www.phrtoolkits.org/toolkits/istanbul--protocol--model--medical>

psikiatrik dhe vonesat apo zvarritjet për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjekët e institucionit apo mjekët specialist, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur. Sikurse Avokati i Popullit edhe KPT (CPT) në rolin e monitoruesit ndërkombëtarë të respektimit të drejtave të të burgosurve, ka rekomanduar se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se, “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Standardet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e të burgosurve, kanë kushtuar vëmendje të veçantë komponentit shëndetësor të të burgosurve, si një e drejtë themelore që duhet të garantohet nga shërbimi shëndetësor i burgjeve në bashkëpunim me shërbimin shëndetësor publik. Në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹⁵.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”;* të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.*

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masat e menjëhershme, për miratimin nga DPB-ja të Rregullores së Brendshme të IEVP Reç, në zbatim të kërkesave të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Të merren masa të menjëhershme, për rritjen e cilësisë të shërbimit shëndetësor për të burgosurit e institucionit, si dhe kryerjen pa vonesa dhe pengesa të vizitave mjekësore nga mjekët e institucionit dhe mjekët specialistë të qendrave shëndetësore (spitali rajonal), mbi bazën e protokolleve shëndetësore të parashikuara në legjisllacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare, për çdo kategori të pacientëve.

¹⁵ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

3. Të merren masa për eliminimin e lagështirës në ambientet e katit të parë të godinave të banimit dhe kryesisht në ambientet e dusheve.
4. Të merren masa të menjëhershme, për plotësimin e vendeve vakante në organikën e institucionit 1 juristi, 3 punonjës psikolog/punë sociale dhe të mjekut psikiatër.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante në stafin e punonjësve të policisë (94 PRB dhe 3 PRM), sipas funksioneve në strukturën organike të institucionit.
6. Të merren masat e nevojshme, për vënien në funksionim të ambientit të palestrës që ndodhet në regjimin e brendshëm të institucionit dhe plotësimin e saj me bazën e nevojshme materiale, me qëllim shfrytëzimin e saj në kohën e lirë nga të burgosurit.
7. Të merren masat e nevojshme, për pajisjen e të punësuarve që kanë mungesa të kartave ID, me qëllim hapjen e numrave të llogarisë në bankat e nivelit të dytë, në zbatimin të VKM-së nr.602, datë 13.10.2021 *“Për shpërblimin financiar të të punësuarve për punën e kryer”*.
8. Të merren masat e menjëhershme për planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të larmishme me karakter kulturor, edukativ dhe sportive me të burgosurit, me qëllim rritjen e interesit, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të burgosurve.
9. Të merren masa të menjëhershme, për përmirësimin e larmishmërisë të gatimit të ushqimit të të burgosurve sipas vakteve ushqimore, si dhe afishimin në kuzhinë të menisë të përditësuar dhe miratuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI